

a. Informacione te pergjithshme

LABOPHARMA sh.p.k, eshte themeluar si një shoqeri me perjegjesi te kufizuar dhe gjendet e regjistruar ne regjistrin tregtar (QKB), identifikuar me NIPT-in K72202013A. Kapitali i regjistruar aktualisht eshte 100,000 ALL dhe zoterohet nga ortaku, Z. Janis Karathano 100%.

Veprimitaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2020 ka qene tregtia te produktave farmaceutike.

b. Deklaratë e pajtueshmërisë me SKK-të

Pasqyrat financiare(individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkosat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

c. Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("ALL").

d. Politikat e Parimet kontabël më domethënëse të pëdorura nga shoqeria, janë si më poshtë:

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekvivalentët e mjeteve monetare. Veprimitari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të Ardhurave të shoqërise dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimitari investuese janë blerja, dhe nxjerra e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekvivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.



Aktivet dhe detyrimet financiare

Një aktiv finanziar ose një detyrim finanziar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi finanziar ose një detyrim finanziar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e trasaksionit) përvèç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion finanziar. Një transaksion finanziar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtëj afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesë që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion finanziar, matja e aktivit finanziar ose detyrimit finanziar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave finanziarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara ne pikën 7dhe 8 te SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përvèçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion finanziar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion finanziar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesit për një instrument të ngashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi finanziar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njojur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit finanziar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njojur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivet dhe detyrimet finanziar shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar ne percaktimet e SKK-2.

Të drejta të arkëtueshme

Kërkosat për t'u arkëtuar, të Ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e të drejtave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provisionet e krijuara për rënien në vlerë), kështu që kërkosat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjeter).



Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përvèç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shítur.

Inventarët i nënshtronhen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të Ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të Ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpérndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të Ardhurave.

Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse aktivitë kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit të hyrë dhe kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillostar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e kostos dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor



Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të Ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivit. Përashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi per te gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma te cilat janë të përafërt me jetegjatesine mesatare te parashikuar te përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normal e perdorura janë ne ndertesa 5 % te dhe per aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

Aktivet afatgjata jomateriale


Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktivit nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërise për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiv jomaterial bëhet me kosto, ndësa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Njohja e të Ardhurave dhe shpenzimeve

Të Ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të Ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra përsasi (vëllim) të blerë.

Të Ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rrëziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe te produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;shuma e të Ardhurave mund të matet me besueshmëri;është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren;kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të Ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të Ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të



matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të Ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përsitim pagesash për përdorime të pronës (rojelltë) dhe dividendë njihen si më poshtë: të Ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të Ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojelltë) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të Ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të Ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtë ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të Ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojne kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e trasaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një javë ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në se cilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zerat ne monedhë te huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin

Kur një përsitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020
jane **1 euro=123.77 leke dhe 1 dollar= 100.84 leke**



Tatimin mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyriën e performancës, përveç tatimit të zërave qe njihen direkt ne kapital,i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuar në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyriën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2020 eshte 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

Detyrimet Afatshkurtra e Afatgjata

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

1. Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjeteve monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 janë si me poshtë:

	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
1 Aktive monetare		
(i) Arka	-	-
(ii) Banka	16,512,541	37,098,046
Totali 1	16,512,541	37,098,046

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejtë me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.



2. Investime

Investimet, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijon:

	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
2 Investime		
(i) Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit	-	-
(ii) Aksionet e veta	4,170,000	4,170,000
(iii) Të tjera financiare	-	-
 Totali 2	 4,170,000	 4,170,000

3. Të drejta të arkëtueshme afatshkurtra

Të drejtat e arketueshme, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijon:

	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
3 Të drejta të arkëtueshme		
(i) Nga aktiviteti i shfrytëzimit (Kliente etj.)	236,086,715	132,137,514
(ii) Nga njësítë ekonomike brenda grupit	-	-
(iii) Nga njësítë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	-	-
(iv) Të tjera	4,429,181	690,363
(v) Kapital i nënshkuar i papaguar	-	-
 Totali 3	 240,515,896	 132,827,877

Në “Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)” janë pasqyruar faturat e papaguara per sherbimet qe shoqeria ka realizuar gjate ushtrimit.

Në “Nga njësítë ekonomike brenda grupit” janë pasqyruar kërkesat debitore ndaj Furnitorëve dhe tatim taksave për Tatim mbi fitimin, Tatim mbi vleren e shtuar dhe parapagime të dhëna.

Ndërsa në “Të Tjera (Debitore të tjerë)” janë pasqyruar Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve dhe Debitore të tjerë.

Drejtumi mendon se të gjitha kërkesat do të arketohen në një periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie në vlere.



4. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
4 Inventarët		
(i) Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	-	-
(ii) Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra	12,456,580	66,409
(v) Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)	-	-
(vi) AAGJM të mbajtua për shitje	-	-
(vii) Parapagime për inventar	-	-
Totali 4	12,456,580	66,409

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2020. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit per hershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda “mesatares se ponderuar”, gjeneruar nga programi “Alpha”.

Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2020 eshte 222,950,538 ALL.

Shuma e inventarit te paraqitur ne ” Lëndët e para” perfaqeson stokun e lendeve te para dhe materialeve ndihmese qe perdoren ne procesin e prodhimit dhe tregtimit te vleresuara me koston mesatare te ponderuar.

Ndersa ne ” Produkte të gatshme” pasqyrohen produktet jo lende te para te perdorura per kryerjen e aktivitetit ekonomik.

Posti ”Mallra per shitje” perbehet nga inventari i mallrave te marra brenda vendit,te destinuara per shitje dhe te vleresuara me koston mesatare te marries.


5. Shpenzime të Shtyra

Shpenzimet e shtyra ne fund te ushtrimit jane ne vleren 11,429,259 ALL.

6. Aktivet Afatgjata

Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, jane matur me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e kostos dhe në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.



Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e meposhteme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit Dhjetor 2020.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Drejtimi mendon se përgjithesisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënjes në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Gjendjet e AAM-ve ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makinri dhe paisje	Aktivet te tjera afatgjata materiale	Totali
	Kosto e AAM-ve me 01.01.2020	-	-	3,062,769	457,035	3,519,804
A	Shthesat	-	-	-	579,356	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Kosto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	3,062,769	1,036,391	4,099,160
	Amortizimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	1,785,976	214,514	2,000,490
B	Amortizimi ushtrimit	-	-	255,358	93,794	349,152
	Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2020	-	-	2,041,334	308,308	2,349,642
	Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	-	-
C	Shthesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-
	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2020	-	-	1,276,793	242,521	1,519,314
D	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	1,021,435	728,083	1,749,518

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejtë me ato qe perdoren per qellime fiskale.

7. Detyrime Afatshkurtëra

“Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit” paraqet detyrimet e mbetur pa u paguar ndaj Furnitoreve te ndryshem ne fund te ushtrimit.

“Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.” paraqet detyrimet e mbetur pa u paguar ndaj personelit dhe detyrimin e muajit Dhjetor 2020.

“Të Pagueshme për Detyrime Tatimore “ perbehet nga tatimi mbi fitimin e vitit 2020, tatimi mbi vleren e shtuar, tatimi mbi te ardhurat personale dhe tatimi ne burim.



Detyrimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
1	Titujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	-	-
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	125,381,705	125,759,229
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet. Paga dhe shpërblime Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	697 80,000	- 17,181
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore Shteti-Tatim mbi fitimin Shteti-Tatim mbi vleren e shtuar Tatim mbi të ardhurat personale Tatimi ne burim	8,993,507 7,585,373 142,334 68,615	862,324 553,693 85,512 57,028
10	Të Tjera të Pagueshme	-	-
Totali		142,252,231	127,334,967

8. Detyrimet Afatgjata-Huate afatgjata

Detyrimet afatgjata ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 paraqiten:

1 Detyrime afatgjata:	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
(i) Titujt e huamarrjes	96,850,000	95,885,000
(ii) Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	-	-
(iii) Arkëtime në avancë për porosi	-	-
(iv) Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	-	-
(v) Dëftesa të pagueshme	-	-
(vi) Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit	-	-
(vii) Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	-	-
(viii) Të tjera të pagueshme	-	-
Totali 1	96,850,000	95,885,000

9. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, perfshin ndyshimet dhe vendimet e depozituara ne QKB. Me 31.12.2020 ai eshte 100,000 ALL, i përbërë nga 1 kuotë, e ndare ne 100 pjese me vlore nominale 1,000 ALL /pjesa.



10. Fitimi (humbja) e vittit finansiar

▪ Te Ardhurat

Te Ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:


Te ardhurat	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
Te ardhurat nga shitja e produkteve	-	-
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve	-	-
Te ardhurat nga shitja e mallrave	363,696,040	124,569,208
Te ardhura te tjera	-	-
Shuma	363,696,040	124,569,208

Të Ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.

Paraqitura ne pasqyrat financiare e te Ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Lloji i shpenzimit	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
> Mallra, Lendet e para dhe sherbimet	222,950,538	70,364,434
> Kosto e Punes	6,571,280	4,914,700
> Amortizimi	349,152	627,629
> Furnitura,nentrajtime dhe sherbime	1,116,958	154,117
> Udhetime e Dicta	273,497	485,498
> Sponsorizime, pritje, dhurata	428,509	1,630,036
> Qira	5,607,364	5,253,146
> Sigurime	35,633	435,280
> Shpenzime bankare	444,292	143,151
> Shpenzime e periudhave te ardhme	2,406,239	2,327,419
> Tatime,taksa dhe derdhje te ngashme	695,737	244,299
> Shpenzime te tjera rrjedhese	18,437,307	16,942,541
Totali	259,316,506	103,522,250



Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat faturuara ose shumat e pagueshme.

Te Ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si difference e te Ardhurave me Shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

11. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2020 jane si vijon:

		REZULTATI TATIMOR 2020	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
I	Fitimi neto para tatimit		105,197,794	20,053,996
II	Shpenzime te pazbriteshme (+)		(374,613)	(1,206,866)
	Amortizime tej normave fiskale		-	-
	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor		-	-
	Gjoba,penalitetë,demshperblime		(374,613)	(1,206,866)
	Provizione qe nuk njihen		-	-
	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta		-	-
	Te tjera		-	-
III	Pjesa e humbjes se mbartur(-)		-	-
IV	Fitimi (Humbja) Tatimore(I+II-III)		105,572,407	21,260,862
	Shpenzimi i tatim fitimit-15%		15,835,861	3,189,129
V	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)		89,361,933	16,864,867

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiscal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

Ne tablele janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të Ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shumën e shpenzimit (të Ardhurës) tatimore të shtyrë, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferençave të përkohshme dhe mbartjen e humbjeve. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 eshte 15%.

12. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit



Asnjë ngjarje e rëndesishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

13. Transaksione te paleve te lidhura e shpjegime mbi palët e lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksi i dhe marredhenie te mundshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, ne 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

14. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2,(të përmirësuar) dhe ka patur çelje per vitin 2019.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i LABOPHARMA sh.p.k dhe janë firmosur nga:

